



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 pika 11) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 07.11.2013, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-3253/13, për z. Bahri Thaçi – Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për Zyrtarin e Lartë, z. Bahri Thaçi, Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.**

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Thaçi është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit ( me datë 18.10.2013), pas së cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë. Me këtë rast ai është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet të cilat duhet të bëj për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Thaçi, në këtë takim ka deklaruar se brenda afatit ligjor do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar në biznes privat dhe do të vazhdoj të ushtroj funksionin e tij publik.

Ndërkohë, z. Thaçi ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë( DPKI.03- 3676/13) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka hequr dorë nga pozita e personit të autorizuar që kishte në Op “Shpetimi” për të ushtruar funksionin e tij publik si Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, me çka ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II.** Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së ;
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës).

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

